

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Novobërdës z. Bajrush Ymeri**

I nderuari z. Ymeri,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Arsim dhe shërbime shëndetësore cilësor;
- Një qeverisje transparente, efikase, moderne dhe të mbështetur në ligj e drejtësi;
- Ambient të pastër;
- Ambient tërheqës për investime;
- Prodhimin e rrymës me erë;
- Hartimin e planit zhvillimor në vlerë prej 80,000 euro - me vëmendje të veçantë në zhvillimin ekonomik të komunës;
- Themelimin e ndërmarrjeve komunale që do të merren me menaxhimin të ujërave, mbeturinave dhe kanalizimeve;
- Sigurimin e ujit të pijshëm për fshatrat që nuk kanë ujë ku si zgjedhje alternative do të jenë burimet në fshatrat Curkovs dhe Tullat;
- Kanalizimin për shtëpitë që nuk janë të kyçura në rrjet;
- Për fshatin Qyllkovc: rregullimin e kanalizimit;
- Aktivizimin e dhomave të stomatologjisë ku dhe do të bëhet kujdestaria (së paku deri në orën 20 apo 24).

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)